

KUSHTET E PERGJITHSHME TE SIGURIMIT PER MJETIN FLUTURUES

Ne zbatim të Ligjit Nr. 10 076 date 12.02.2009, " Per sigurimin e detyrueshem ne sektorin e transportit" ndryshuar me Ligjin Nr. 10 455 date 21.07.2011 si dhe Rregulloren Nr. 53 date 25.06.2009, "Per trajtimin e demeve qe mbulohen nga kontrata e sigurimit te detyrueshem ne sektorin e transportit", "ANSIG"Sh.a ofron produktin e meposhtem.

Titujt dhe shpjegimet dytësore janë futur vetëm me qëllim të lehtësimit të kuptimit dhe nuk do të vlerësohen si pjesë e Kushteve të Pergjithshme.

Siguruesi bie dakord të sigurojë humbje, dëme ose përgjegjësi të shkaktuara nga një aksident i ndodhur gjatë Periudhës së Sigurimit, në masën dhe mënyrën e parashikuar.

SEKSIONI I HUMBJA DHE OSE DEMI I MJETIT FLUTURUES

1. Mbulimi

- Siguruesi me zgjedhjen e tij do të paguajë për zëvendësimin ose riparimin, humbjen aksidentale dhe ose dëme të mjetit fluturues përshkruar në Skedarë (rubrikat e policës), shkaktuar nga rreziqet e mbuluara, duke përfshirë zhdukjen, nëse për Mjetin Fluturues nuk ka të dhëna (raportime) për 60 ditë mbas fillimit të Fluturimit, por duke mos kaluar Shumen e Siguruar të rene dakort midis paleve.
- Nëse Mjeti Fluturues sigurohet ketu për rreziqet e Fluturimit, Siguruesi do të paguajë në shtesë, shpenzime të arësyeshme emergjence, të kryera nga i Siguruari në nevojë të shpëtimit të menjëhershëm të Mjetit Fluturues që pason dëme gjatë uljes së detyruar, deri në 10 %, të Shumës së Siguruar të Mjetit Fluturues.

2. Përjashtimet e aplikueshme vetëm në këtë seksion.

Siguruesi nuk do të jetë përgjegjës për:

- amortizimin, prishjen, avarinë defektin ose mosfunksionimin shkaktuar në çdo Njësi të Mjetit Fluturues dhe çdo pasojë prej tyre brenda së njëjtës Njësi;
- dëme në çdo Njësi prej çdo shkakut që ka efekt që shtohet ose rritet progresivisht, përveç dëmit që i cilësohet një ngjarje të vetme e regjistruar.

3. Kushte të aplikueshme vetëm në këtë seksion

(a) Nëse mjeti fluturues dëmtohet

- asnjë zmontim ose riparim nuk do të fillojë pa miratimin e Siguruesit, përveç atij që është i nevojshëm në interes të shpëtimit, ose për të parandaluar dëme të mëtejshme, ose në zbatim të urdhërave të lëshuar nga autoriteti i duhur;

- Siguruesi do të paguaj vetëm për riparimin dhe transportimin e materialeve dhe të punonjësve, llogaritur sipas metodës më ekonomike, po të mos kete rënë dakord ndryshe Siguruesi me të Siguruarin.
- (b) Nëse Siguruesi ushtron të drejten e zgjedhjes për të paguar ose zëvendësojë Mjetin Fluturues
- Siguruesi mund të marrë Mjetin Fluturues (së bashku me të gjithë dokumentet e regjistrimit, rregjistrimin e titullit (pronësisë) së tij, si i shpëtuar;
 - mbulimi i dhënë prej këtij Seksioni lidhur me Mjetin Fluturues përfundon, bile edhe nëse Mjeti Fluturues mbahet prej të Siguruarit, për efekt të llogarive të kompensimit financiar ose ndryshe;
 - Mjetit Fluturues i zëvendësuar do të jetë i së njejtës markë dhe tip dhe arësyeshem në të njeten gjendje fizike, po të mos jetë rënë dakord ndryshe me të Siguruarin.
- (c) Përveçse në rastet kur i Siguruesi ushtron zgjedhjen e tij të paguajë ose zëvendësojë Mjetin Fluturues, do të ketë zbritje nga kërkesa për tu dëmshpërblyer, sipas paragrafit 1(a), të këtij seksioni:
- pjesa e specifikuar në Policen e Sigurimit
 - të tillë pjesë të Kostos së Kontroll-riparimit të çdo Njësie të riparuar ose zëvendësuar të Mjetit Fluturues, sa koha e përdorimit të saj mbart (zë), në jetëgjatësinë e Njësisë së Kontrolluar-riparuar.
- (d) Po të mos zgjedhë Siguruesi të marrë Mjetin Fluturues, si të shpëtuar, Mjeti Fluturues do të mbetet gjatë gjithë kohës pronë e të Siguruarit, i cili nuk do të ketë të drejtë ta braktisë atë, për llogari të Siguruesit.
- (e) Asnjë kërkesë për dëmshpërblyer nuk do të paguhet sipas këtij seksioni, nëse një sigurim tjetër i pagueshem në vijim të humbjes ose dëmit të mbuluar sipas këtij seksioni, ka qenë ose bëhet efektiv nga ose në emër të të Siguruarit pa dijeninë ose miratimin e Siguruesit.

SEKSIONI II

PERGJEGJËSIA LIGJORE NDAJ PALEVE TE TRETA (Përveç Pasagjerëve)

1. Mbulimi

Siguruesi do të dëmshpërblejë të Siguruarin për të gjitha shumat për të cilat i Siguruarit do të bëhet ligjërisht përgjegjës të paguajë, dhe do të paguajë, si dëme kompensimi (duke përfshirë kostot e ngarkuara kundrejt të Siguruarit) në lidhje me dëmtime trupore

aksidentale (me vdekje ose te tjera) dhe dëme aksidentale në pasuri të shkaktuar prej Mjetit Fluturues ose nga çdo person ose objekt i rënë prej tij.

2. Përrjashtime të zbatueshme vetëm në këtë seksion

- dëmtimet fizike (me vdekje ose te tjera) ose humbjet e pësuar nga çdo drejtor ose i punësuar i të Siguruarit ose partner në biznesin e të Siguruarit, ndërsa vepron përgjatë detyrave të tij të punësimit për llogari të të Siguruarit;
- dëmtimet fizike (me vdekje ose te tjera) ose humbjet e pësuar nga çdo anëtar i fluturimit, kabinës ose ekuipazh tjetër ndërsa është i zënë me veprimtari në Mjetin Fluturues;
- dëmtimet fizike (me vdekje ose te tjera) ose humbjet e pësuar nga çdo pasagjer ndërsa është duke hyrë, është në bord ose duke zbritur nga Mjeti Fluturues;
- humbjet dhe ose dëmet e çdo pasurie që i përket ose është nën kujdes, ruajtje ose kontrollin e të Siguruarit;
- kerkesat për dëmshpërlim të përjashtuara nga Klauzolat bashkëlidhur (të atashuara) të Zhurmave dhe Ndotjes dhe Klauzola Përrjashtuese e Rreziqeve të Tjera.

(3) Kufijtë e dëmshpërblimit të zbatueshëm në këtë seksion

Përrgjegjësia e Siguruesit sipas këtij Seksioni nuk do të kalojë shumen e përcaktuar . Siguruesi do rimbursojë në shtesë çdo kosto ligjore dhe shpenzim të kryer me miratimin me shkrim të tij në mbrojtje të çdo veprimi (padie) që mund të paraqitet kundrejt të Siguruarit, në lidhje me çdo kërkesë për dëme kompensuese të mbuluara prej këtij Seksioni, por nëse shuma e paguar ose e përlllogaritur për zgjidhjen e të tillë kerkese për dëmshpërblim kalon Limitin e Dëmshpërblimit atëherë përrgjegjësia e Siguruesit lidhur me të tillë shpenzime dhe kosto ligjore do të kufizohet në të tillë pjesë të shpenzimeve dhe kostove ligjore të përrmendura sa Limiti i Dëmshpërblimit jep me shumen e paguar për dëme kompensuese.

SEKSIONI III

PERGJEGJËSIA LIGJORE NDAJ PASAGJEREVE

1. Mbulimi

Siguruesi do të dëmshpërblejë të Siguruarin lidhur me të gjitha shumat për të cilat i Siguruarit do të bëhet ligjërisht përrgjegjës të paguajë, dhe do të paguajë, si dëme kompensimi (duke përrfshirë kostot e përlllogaritura kundrejt të Siguruarit) në lidhje me:

- dëme trupore aksidentale (me vdekje ose te tjera) të çdo pasagjeri ndërsa është duke hyrë, është në bord ose duke zbritur nga Mjeti Fluturues

- humbje ose dëme të bagazhit dhe sendeve personale të pasagjereve shkaktuar prej një aksidenti në Mjetin Fluturues.

Me kusht që:

- përpara se pasagjeri të hyp në Mjetin Fluturues, i Siguruari do të ketë marre të tillë masa sa janë të nevojshme të perjashtojë ose kufizojë përgjegjesinë për dëmshpërblime, sipas (a) dhe (b) më sipër deri në masën e lejuar nga ligji;
- nëse masat e përmendura në kushtin më sipër përfshijnë lëshimin e një bilete kontroll-bagazhi, e njëjta do të dorëzohet saktësisht e plotësuar tek pasagjeri një kohe të mjaftueshme përpara se pasagjeri të hyp në Mjetin Fluturues.

Në rast të pamundësisë së zbatimit të kushteve ose , përgjegjësia e Siguruesit sipas këtij seksioni nuk do të kalojë shumen e përgjegjësisë ligjore, nëse ka të tillë, që do të kishte egzistuar, nëse kushti të kishte qenë në pajtim me të.

2. Përjashtime të zbatueshme vetëm në këtë seksion

Siguruesi nuk do të jetë përgjegjës për dëmtime trupore (me vdekje ose të tjera) ose humbje të pësuar nga secili prej:

- drejtor ose i punësuar i të Siguarit ose partner në biznesin e të Siguarit, ndërsa vepron përgjatë plotësimit të detyrave të tij të punësimit, për llogari të të Siguarit;
- anëtar i ekuipazhit të fluturimit, kabinës ose ekuipazh tjetër ndërsa është i zënë me veprimtari në Mjetin Fluturues;

3. Kufijtë e dëmshpërblimit të zbatueshëm në këtë seksion

Përgjegjësia e Siguruesit sipas këtij Seksioni nuk do të kalojë shumen e përcaktuar. Siguruesi do rimbursojë në shtesë çdo kosto ligjore dhe shpenzim të kryer me miratimin me shkrim të tij në mbrojtje të çdo veprimi (padie) që mund të paraqitet kundrejt të Siguarit, në lidhje me çdo kërkesë për dëme kompensuese të mbuluara prej këtij Seksioni, por nëse shuma e paguar ose përlllogaritur për zgjidhjen e të tillë kerkese kalon Limitin e Dëmshpërblimit atëherë përgjegjësia e Siguruesit lidhur me të tillë shpenzime dhe kosto ligjore do të kufizohet në të tillë pjesë të shpenzimeve dhe kostove ligjore të përmendura sa Limiti i Dëmshpërblimit jep me shumen e paguar për dëme kompensuese.

SEKSIONI IV

(A) Perjashtime të Përgjithshme të Zbatueshme në të Gjithë Seksionet

1. Ndërsa Mjeti i Fluturimit përdorej për çfarëdo qëllimi ilegal ose për çdo qëllim përveçse atyre të deklaruar.

2. Ndërsa Mjeti i Fluturimit është jashtë kufijve gjeografike të deklaruar, po të mos jetë për shkak të forcës madhore.
3. Ndërsa Mjeti i Fluturimit pilotohej prej çdo personi përveç si janë deklaruar, përveçse kur Mjeti Fluturues vepron në tokë drejtuar nga çdo person kompetent për këtë qëllim.
4. Ndërsa Mjeti i Fluturimit transportohet prej çdo mjeti transporti, përveçse si rezultat i një aksidenti, që i jep shkak një kerkese për dëmshpërblim sipas Seksionit I, të kushteve të përgjithshme.
5. Ndërsa Mjeti i Fluturimit ulet ose ngrihet ose duke u përpjekur për të kryer të njëjtat veprime, prej një vendi që nuk përputhet me rekomandimet e deklaruara prej prodhuesit të Mjetit Fluturues, përveçse si rezultat i forcës madhore.
6. Përgjegjësia e marrë përsipër ose të drejtat e pa ushtruara nga i Siguruari, sipas çdo marreveshje (përveçse një bilete kontroll-bagazhi, lëshuar sipas Seksionit III, ketu), përjashtuar masën që e tillë përgjegjësi do ti ngarkohej të Siguarit, në mungesë të të tillë marreveshje.
7. Ndërsa numri i përgjithshëm i pasagjereve të ngarkuar në Mjetin Fluturues, kalon numrin maksimal të pasagjereve përcaktuar.
8. Për kërkesat për dëmshpërblim të cilat janë të pagueshme nga çdo tjetër policë ose polica, përveç sa lidhur me çdo tejkalim përtej shumës që do të ishte paguar sipas të tillë police ose policash të tjera, sikur kjo Policë të mos kishte qenë në fuqi.
9. Për kërkesat e përjashtuara prej Klauzolës Bashkëngjitur të Përjashtimeve të Rreziqeve Bërthamore.
10. Për kërkesat për dëmshpërblim shkaktuar nga:
 - Lufta, pushtimi, veprimet e armiqve të jashtëm, aktet keqdashëse (nëse lufta është deklaruar ose jo), lufta civile, rebelimi, revolucioni, kryengritja, vendosja e ligjit ushtarak, marrja e pushtetit me dhunë ose përpjekja për uzurpimin e pushtetit nga ushtria.
 - Çdo shpërthim keqdashës i çdo arme luftarake, përfshi ndarjen ose bashkimin atomik ose bërthamor ose tjetër reaksion të ngjashëm ose fuqi ose lëndë radioaktive.
 - Grevat, turbullira të dhunshme, turbullira civile ose veprime të dhunshme me objekt çeshtje të punës.
 - Çdo akt të një ose më shumë personave nëse janë ose jo agentë (punonjës) të një Fuqie të pavarur (shteti), për qëllime politike ose terroriste edhe nëse humbja ose dëmi që rezulton prej tyre është aksidental ose i qëllimshëm.
 - Çdo akt keqdashës ose sabotazhi.

- Konfiskimi, shtetëzimi, ndalimi, shtrëngimi, mbajtja, shpronësimi, rekuizimi për të drejten e pronës ose përdorimit nga ose sipas urdhërit të çdo Qeverie (civile, ushtarake ose kur vepron de fakto, si e tillë) ose autoriteti lokal ose qendror.
- Rrëmbimi ose çdo ndalim i paligjshëm ose ushtrimi keqdashës i kontrollit të Mjetit Fluturues ose ekuipazhit në Fluturim (duke përfshirë çdo përpjekje për këtë ndalim dhe kontroll), kryer prej çdo personi ose personash në Mjetin Fluturues, ku Mjeti Fluturues vepron pa miratimin e të Siguararit.
- Për mëteper kjo Policë nuk do të mbulojë kerkesat për dëmshpërblim të ardhura ndërsa Mjeti Fluturues është jashtë kontrollit të Siguararit, për shak të veprimit të secilit prej rreziqeve të mësipërme.
- Mjeti Fluturues do të gjykohet ti jetë kthyer kontrollit të Siguararit, kur kthehet në gjendje të sigurtë tek i Siguari, në një aeroport jo të përjashtuar nga kufijtë gjeografikë të kësaj Police dhe tërësisht të përshtatshëm për veprimtarinë e Mjetit Fluturues (i tillë kthim i sigurtë do të kërkojë që Mjeti Fluturues të parkohet me motorr të fikur dhe i pa kërcënuar ose shtrënguar nga askush).

(B) Kushte Paraprake të Zbatueshme në të gjitha Seksionet.

Është e nevojshme që i Siguari kontrollon dhe plotëson kushtet pasuese përpara se Siguruesi të ketë çdo përgjegjësi të bëjë çdo pagesë sipas kësaj Police

1. Siguruesi gjatë gjithë kohës vepron me kujdesin e duhur dhe bën dhe bie dakord për të kryer çdo gjë praktikisht të arësyeshme për të shmangur aksientet dhe të shmang ose zvoglojë çdo humbje.
2. Siguruesi do të veprojë në përputhje me të gjitha urdhërat dhe kerkesat e navigimit dhe vlefshmërisë së fluturimit të Mjetit Fluturues lëshuar prej çdo autoriteti kompetent me pasojë veprimtarinë e sigurtë të Mjetit Fluturues dhe do të garantajë që:
 - Mjeti Fluturues është i vlefshëm për të fluturur në fillimin e çdo fluturimi;
 - të gjithë librat e regjistrimit dhe rregjistrat e tjerë të kerkuar nga urdhërat zyrtarë në fuqi lidhur me Mjetin Fluturues, do të përditësohen nga koha në kohë, dhe do ti paraqiten Siguruesit ose Agjentëve të tij, sipas kerkesës së tyre;
 - punonjësit dhe agjentët e të Siguararit veprojnë në përputhje me të tillë urdhëra the kerkesa.
3. Njoftim i menjëhershëm i çdo ngjarje që ka gjasë të ngrëjë një kerkese për dëmshpërblim sipas ketyre kushteve.

Në të gjitha rastet i Siguruari do të:

- ofrojë detaje të plota me shkrim për të tillë ngjarje dhe ti dërgojë menjëherë njoftimin e çdo kerkese dëmshpërblimi, me të gjitha letrat dhe dokumentet që lidhen me to;
- japë njoftim për çdo gjykim penal të pritshëm;
- japë të tillë informacione të mëtejshme dhe ndihmë, sipas kerkeses së arësyeshme të Siguruesit;
- mos veprojë në asnjë rast për dëmtimin ose paragjykimin e interesit të Siguruesit.
- I Siguruari nuk do marrë asnjë përgjegjësi ose të paguajë ose të ofrojë ose premtojë të paguajë, pa miratimin me shkrim të Siguruesit.

(C) Kushte të Përgjithshme të Zbatueshme në të gjitha Seksionet.

1. Siguruesi do të ketë të drejten (nëse zgjedh të veprojë ashtu), në çdo kohë dhe për aq sa dëshiron, të marrë kontroll të plotë të të gjithë negociatave dhe procedurave dhe në emër të të Siguarit, të zgjidhë, mbrojë ose ndjekë çdo kerkese për dëmshpërblim.
2. Mbasi një dëmshpërblim jepet ose një pagesë bëhet prej Siguruesve sipas kësaj Police, ato do të zvendësojnë në të drejten dhe mjetet ligjore të Siguarin, i cili do të bashkëpunojë dhe do të kryejë të gjitha gjërat e nevojshme, për të ndihmuar Siguruesin të ushtrojë të tillë të drejta dhe mjete ligjore.
3. Nëse do të ketë ndryshime në rrethanat ose natyrën e rrishtit (Objektit të Sigurimit) të cilat janë të rëndësishme për këtë kontratë, i Siguruari do të japë njoftim të menjëhershëm për të Siguruesit dhe asnjë kerkese për dëmshpërblim që rezulton si pasojë e këtyre ndryshimeve nuk do të jetë e dëmshpërblyeshme po të mos jenë pranuar nga Siguruesi këto ndryshime.
4. Polica e sigurimit mund të anulohet prej secilit Siguruesit ose të Siguarit duke i bërë tjetrit një njoftim 10 ditor me shkrim, për të tillë anulim. Nëse anulohet prej Siguruesit, Ai do të kthejë një pjesë proporcionale të primit në lidhje me periudhën e pa konsumuar të Policës. Nëse anulohet prej të Siguarit një kthim primi do të bëhet me zgjedhjen e Siguruesit. Nuk do të ketë kthim primi lidhur me çdo Mjet Fluturimi për të cilin një humbje është paguar ose është e pagueshme sipas kësaj Police.
5. Polica e sigurimit nuk do të transferohet (të tretëve) në tërësi ose pjesërisht, përveç se me miratimin e Siguruesit.

-
6. Polica e sigurimit ndermjet palëve këtu shprehimisht bien dakord që kjo (Polica) nuk do të interpretohet si Policë sigurimi marine.
 7. Polica e Sigurimit do të interpretohet në përputhje me ligjin shqiptar dhe çdo mosmarreveshje ose ndryshim ndërmjet Siguruesit dhe të Siguruarit do t'i paraqitet arbitrazhit në pajtim me parashikimet Statutore (ligjore) për arbitrazhin në fuqi.
 8. Kur dy ose më shume Mjete Fluturues sigurohen ketu termat e këtyre kushteve zbatohen veçanërisht tek secili prej tyre.
 9. Pavarësisht përfshirjes këtu të më shumë se të një të Siguruarit, me shtojcë ose ndryshe, përgjegjësia totale e Siguruesit në lidhje me secilin prej të Siguruarve nuk do të kalojë Kufirin/jtë e Dëmshpërblimit ,
 10. Nëse i Siguruarit bën çdo kerkese për Dëmshpërblim duke ditur që kjo është fallso ose mashtruese lidhur me shumën ose tjetër kjo Policë do të bëhet e pavlefshme dhe të gjitha kërkesat për dëmshpërblim do të zhvleftësohen.